

VENDIM
Nr. 526, datë 7.9.2023

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 1163, DATË
24.12.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR NGRITJEN E
SEKRETARIATIT NË KUADËR TË VEPRIMTARISË SË MBAJTJES SË
SEKRETARIATIT TË ‘BOLOGNA FOLLOW UP GROUP’ NGA REPUBLIKA E
SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 1163, datë 24.12.2020, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4. Qëllimi parësor i punës së nënkryetarit të “*Bologna Follow Up Group*” dhe sekretariatit të “*Bologna Follow Up Group*” (në vijim “BFUG”) është kryerja të gjitha funksioneve dhe detyrimeve që u lindin në zbatim të rregullave dhe procedurave të funksionimit të BFUG-së. Detyrat e tyre ushtrohen sipas kohëzgjatjes, si më poshtë vijon:

a) Nënkyetari i BFUG-së, kryetari dhe nënkryetari i sekretariatit të BFUG-së deri në realizimin e detyrimeve sa i takon kalimit të detyrës nënkryetarit dhe sekretariatit të ardhshëm të BFUG-së dhe përfaqësimit në takimet vijuese si nënkryetar i BFUG-së dhe kryetar/nënkryetar i sekretariatit të BFUG-së dalës, deri më 31 dhjetor 2024;

b) Punonjësit e sekretariatit të BFUG-së deri më 31 korrik 2024, me përmbushjen e detyrimeve për kalimin e detyrës sekretariatit të ardhshëm të BFUG-së.

Nënkryetari i BFUG-së asistohet nga grupi i punës, i ngritur me urdhër të Kryeministrit, për të mbështetur aktivitetet e tij dhe për koordinimin e veprimtarive që do të organizohen deri në përfundim të periudhës së mbajtjes së këtij pozicioni nga Republika e Shqipërisë, si dhe koordinimin e punës për organizimin e Konferencës Ministrore dhe Dialogut të Politikave Globale në maj 2024. Përbërja dhe detyrat e grupit të punës përcaktohen në urdhrin e Kryeministrit, sipas kërkesës së nënkryetarit të BFUG-së dhe mbi bazën e propozimit të përcjellë nga ministri përgjegjës për arsimin.”.

b) Pika 5 shfuqizohet.

c) Pika 7 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“7. Sekretariati drejtohet nga kryetari dhe përbëhet nga personel i punësuar me kohë të plotë, ekspertë dhe personel i punësuar me kohë të pjesshme, si më poshtë vijon:

a) Një ekspert i nivelit të lartë në pozicionin e kryetarit të sekretariatit të BFUG-së, i angazhuar me kohë të plotë ose të pjesshme, i cili organizon dhe drejton të gjithë veprimtarinë e sekretariatit;

b) Një ekspert i nivelit të lartë në pozicionin e nënkryetarit të sekretariatit të BFUG-së, i angazhuar me kohë të plotë ose të pjesshme, i cili asiston kryetarin e sekretariatit në kryerjen e detyrave të tij;

c) Ekspertë të nivelit të lartë, të angazhuar me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme në pozicionin e anëtarëve të sekretariatit të BFUG-së, për një angazhim mujor në total të të gjithë ekspertëve që punësohen, deri në 968 (nëntëqind e gjashtëdhjetë e tetë) orë pune/muaj;

ç) Ekspertë të angazhuar me kohë të plotë ose të pjesshme në pozicionin e anëtarit të sekretariatit të BFUG-së për një angazhim mujor në total të të gjithë ekspertëve që punësohen, deri në 1 144 (një mijë e njëqind e dyzet e katër) orë pune/muaj.

Personeli i sekretariatit duhet të ketë njohuri shumë të mira në fushën e arsimit të lartë dhe të procesit të Bolonjës.

Struktura e sekretariatit, pozicionet me kohë të plotë apo të pjesshme, si dhe detyrimet kontraktuale të personelit të sekretariatit miratohen nga ministri përgjegjës për arsimin mbi bazën e propozimit të kryetarit të sekretariatit të BFUG-së. Personeli i sekretariatit emërohet dhe lirohet nga detyra nga ministri përgjegjës për arsimin ose nga personi i deleguar prej tij për këtë qëllim, në përputhje me dispozitat e Kodit të Punës, nëpërmjet thirrjeve për shprehje interesi.”.

c) Pika 12 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“12. Niveli i shpërblimit për punën e kryer nga nënkryetari i BFUG-së, personeli i sekretariatit të BFUG-së, personeli i ministrisë përgjegjëse për arsimin apo institucioneve të tjera shtetërore, që ofrojnë mbështetje jashtë kohës normale të punës dhe anëtarët e grupit të punës, të përcaktuar sipas këtij vendimi, është, si më poshtë vijon:

a) Për nënkryetarin e BFUG-së dhe punonjësit e sekretariatit të BFUG-së, shpërblimi t’u referohet nivelit të pagave të personelit në institucionet publike të arsimit të lartë, të përcaktuara me vendimin nr. 748, datë 11.6.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit akademik të institucioneve publike të arsimit të lartë”, të ndryshuar, si më poshtë vijon:

i. Nënkyetari i BFUG-së, kryetari dhe nënkryetari i sekretariatit sa paga e personelit akademik “Rektor”;

ii. Ekspertët e nivelit të lartë dhe/ose të huaj/nga diaspora shqiptare, të punësuar me kohë të plotë ose të pjesshme, referuar pagës së personelit akademik të kategorisë “Profesor”;

iii. Ekspertët e punësuar me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme, referuar pagës së personelit akademik që zotëron gradën shkencore “Doktor”.

b) Staf i ministrisë përgjegjëse për arsimin apo institucioneve të tjera shtetërore, i cili ofron mbështetje, jashtë kohës normale të punës, në realizimin e detyrimeve të sekretariatit shqiptar të BFUG-së sa u takon çështjeve financiare, ligjore apo menaxhimit të grandit të BE-së për sekretariatit e BFUG-së, praktikave që lidhen me realizimin e udhëtimeve të personelit të sekretariatit, në kuadër të realizimit të detyrimeve të tyre respektive, mirëmenaxhimit e faqes *web* www.ehea.info apo shërbime të tjera që do të kryhen në funksion të veprimtarisë së sekretariatit, sipas kërkesave që do të përcillen nga kryetari/nënkryetari, do të konsiderohet si ekspert me kohë të pjesshme, brenda totalit të orëve të përcaktuara në shkronjat “c” dhe “ç”, të pikës 7, të këtij vendimi;

c) anëtarët e grupit të punës, të përcaktuar në pikën 4 të këtij vendimi, shpërblehen në masën 25 000 (njëzet e pesë mijë) lekë në muaj.”.

d) Pas pikës 12 shtohet pika 12/1, me këtë përmbajtje:

“12/1. Ngarkohen nënkryetari i BFUG-së, sekretariati, grupi i punës që asiston atë dhe ministria përgjegjëse për arsimin të marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar organizimin e Konferencës Ministrore dhe dialogut të politikave globale në maj 2024 dhe të gjitha aktivitetet që do të parashikohen deri në zhvillimin e tyre, si dhe të bashkëpunojnë për organizimin e programeve kulturore dhe promovuese në kuadër të këtyre aktivitetet me ministrinë përgjegjëse për turizmin dhe kulturën.”.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Ministria e Kulturës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama